



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 20.03.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për Ri-Shqyrtim** të datës: 17.03.2025, të parashtruar nga OE BENI - COM SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri" me nr. të Prokurimit 613-24-9854-5-1-1., Autoriteti kontraktues nxjerr:

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim, **kërkesë e paraqitur më dt; 17.03.2025, nga OE BENI - COM SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:

"Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri" me nr. të Prokurimit 613-24-9854-5-1-1.

Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, i publikuara në platformen e prokurimit të datës: 12.03.2025.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit ka pranuar kërkesë për Rishqyrtim më dt: 17.03.2025, për aktivitetin e prokurimit me titull "Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të R" me nr. të Prokurimit 613-24-9854-5-1-1, përmes sistemit elektronik në E-prokurim.

Sa i përket qasjes suaj sic e keni pershkruar ne kërkesën për Rishqyrtim, se kinse nuk ju është lejuar në të gjithë OE, konsiderojmë që OE Beni Com përmes përfaqësuesit me autorizim ka marrur qasjen e kerkuar, që dëshmohet edhe me nënshkrimin në qasjes, të cilën do ta keni shtojcë të këtij Vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT

Drejtoria e prokurimit Lipjan

Procesverbal për qasje në dokumentacion

I hartuar në Lipjan me date 25.11.2024

"BENI- COM SH.P.K ka kërkuar qasje në dokumentacion për tenderin e shpallur
"Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufe të Ri)
"me numer të prokurimit G13-24-9854-5-1-1
Përfaqësuesi nga Operatori Ekonomik, Agron Selmani me autorizim ka pasë qasje në
dokumentacion në dosjet e kësaj lënde.

Agron Selmani

Lipjan 25.11.2024

Në raste se keni pasur dicka të pa kjarhtë, OE në fjalë është dashur të kontaktoj në e-mailin zyrtar i cili është pershkruar në Dosjen e Tenderit, dhe jo ne e-maile tjera.
Shif DT e datës 20.09.2024, dhe komunikimet se si mund të bëhen.
Njëшту OE ka mundur të kërkoj prap përmes sistemit E-Prokurimi, sic e keni paraqitë kërkesën për qasje.

Dhe ju në kërkesën për Rishqyrtim të datës: 26.11.2024, nuk keni pasur fare pretendime kundërjt OE i cili tani është rekomandar për Kontratë.

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve
Përshkrimi i Nenit	Nr. i Nenit.	
Fusha e tenderit	1.1	Autoriteti Kontraktues (AK) është: Emri i AK: KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN Adresa e AK: SHQIPERIA Qyteti: LIPJAN Kodi Postar: 14000 Adresa Elektronike: Personi Kontaktues: Bekim Shabani E-mail: bekim.g.shabani@rks-gov.net Telefoni: 038 200 41526 Faks:
	1.2	Titulli i kontratës dhe numri identifikues i aktivitetit të prokurimit është: Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufe të Ri 613-24-9854-5-1-1
	1.3	Data e dorëzimit të Njoftimit të Kontratës në KRPP: 19.09.2024 Versioni i plotë i njoftimit të kontratës të dërguar në KRPP mund të shkarkohet nga faqja elektronike e KRPP-së www.krpp.rks-gov.net
	1.4	Tenderi duhet të dorëzohet në adresën e përmendur në 23.1 përveç nëse nuk është e përmendur në 23.1 në adresën e përmendur në 1.1
Qëllimi i Kontratës	2.1	Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 45000000-7 Qëllimi i kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim: <i>[shëno përshkrimin e përgjithshëm të punëve]</i> Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufe të Ri Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufe të Ri

Përgjigjeja në pretendimin e parë:

1. Sa i përket referencave OE ka përmbushur kërkesat e AK-së sipas DT. Sepse tek Kërkesa 1 është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlerë prej 750,000.00 Euro për (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, Sqarim OE ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme për projekte të ngjashme lidhur me këtë AP që ka të bëjë me ndërtim dhe me infrastrukture. Sqarim: Sikur të ishte në kërkesë në NJK dhe TD për projekte të tilla do ishte i arsyeshëm pretendimi juaj.

Ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigjeja në pretendimin e dytë:

2. Në sqarimet shpesh të kërkuara nga AK në lidhje me teknikun e ndërtimtarisë të cilin e ka të paqartë në listen e stafit profesional, OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur dëshmi të knaqshme të cilat plotësojnë kërkesat e AK-së. Komisioni i vlerësimit duke u bazuar në nenin 59.4 të LPP-së dhe nenin 45,19, 45,20, 45,21 të Rregullores Nr.002/2024 për Plotesimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022, vlerëson se është devijim i vogël, raporti Inxhinjer dhe Teknik, dhe Ajo që është më kryesorja nuk paraqet ndonjë pengesë për realizim të projektit.

Ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigjeja në pretendimin e tretë:

3. AK me date: 21.02.2025, mbështetur në dispozitën ligjore sipas nenit 72 të LPP-së, ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontrate për disa pika të cilat është dashur të kerkohet sqarime shtese sipas LPP-se. Ne mesin e ketyre sqarimeve kane qene edhe kerkesa 3. Lista e paisjeve teknike; k) Paisje metalike per shallona betoni = (min 400m2).


OE ne pergjigjen e tije eshte deklaruar se ka me shume se 400m2 pasije metalike per shallona betoni dhe perveq deshmise se ofruar me oferte (Dud doganor), ne sqarimin shtese te kerkuar nga AK, OE ka ofruar edhe prospektin e prodhuesit ku jane te paraqitura dimesionet, pershkrimi, m2, peshat e shallonave te betonit si dhe fakte të tjera të cilat janë fakte bindëse për AK.

Ky pretendim është i pa bazuar.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 20.03.2025, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtör i Prokurimit